

VENDIM
Nr. 161, datë 6.10.2016

MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “BALKAN GREEN ENERGY”
SHPK ME NR. 3, SERIA PV03K, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE NR. 69, DATË 12.12.2007

Në mbështetje të neneve 16; 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 930, datë 2.9.2009, “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë italiane “Essegei”, s.p.a, miratuar me vendimin nr. 148, datë 22.3.2007, të Këshillit të Ministrave; nenit 15 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE); pikat 2.2, 2.3 dhe 2.5, të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut, për modifikimin e licencës së shoqërisë “Balkan Green Energy”,

konstatoi se:

- Shoqëria FAVINA sh.p.k. në cilësinë e pronarit të HEC “Voskopojë” i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 100 prot., datë 21.1.2016, duke kërkuar rritjen e fuqisë së instaluar të këtij HEC-i.

- ERE pas verifikimeve të bëra, konstaton se mbështetur në vendimin nr. 69, datë 12.12.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është shoqëria koncesionare “Balkan Green Energy” sh.p.k. e licencuar për të ushtruar aktivitetin e prodhimit nga HEC “Voskopoja”.

- ERE me shkresën nr. 101/1 prot., datë 20.4.2016, i është drejtuar MEI-t, në lidhje me saktësimin e pronësisë së HEC “Voskopojë”.

- MEI është përgjigjur me shkresën nr. 2810/1 prot., datë 23.5.2016, përmes së cilës i ka kërkuar ERE-s, zbatimin e marrëveshjes së koncesionit në përputhje me VKM-në nr. 930, datë 2.9.2009.

- VKM nr. 930 datë 2.9.2009, “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur ndërmjet ministrisë së ekonomisë, tregtisë dhe energjetikës dhe shoqërisë italiane “Essegei”, s.p.a, miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave ka hequr nga lista e HEC-eve për të cilat është licencuar shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k. HEC-et: “Piqeras”, “Lozhan” dhe “Voskopojë” në zbatim të nenit 5, i cili përcakton se: “Trajtimi i hidrocentraleve Piqeras, Lozhan dhe Voskopojë, do të merren në dorëzim dhe do të trajtohen nga organi shtetëror i autorizuar.”.

- Neni 43, pika 1, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikon se: ERE mund të modifikojë licencën, me iniciativën e vetë, kur ndryshojnë kushtet e kontratës koncesionare.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën me numër nr. 3, seria PV03K, dhënë shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k., me vendim të Bordit të ERE-s nr. 69, datë 12.12.2007, në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 930, datë 2.9.2009. (Tabela me ndryshimet bashkëlidhur.)

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, si dhe shoqërinë Balkan Green Energy sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet

HEC “Bulqizë”, me fuqi 0,6 MW (Dibër)
HEC “Homesh”, me fuqi 0,395 MW (Dibër)
HEC “Zerqan”, me fuqi 0,625 MW (Dibër)
HEC “Arras”, me fuqi 4,8 MW (Dibër)
HEC “Orgjost”, me fuqi 1,2 MW (Kukës)
HEC “Lekbibaj”, me fuqi 1,4 MW (Tropojë)
HEC “Dukagjin”, me fuqi 0,64 MW (Shkodër)
HEC “Marjan”, me fuqi 0,2 MW (Korçë)
HEC “Barmash”, me fuqi 0,83 MW (Kolonjë)
HEC “Treske 2”, me fuqi 0,25 MW (Korçë)
HEC “Nikolice”, me fuqi 0,7 MW (Korçë)
HEC “Funares”, me fuqi 1,92 MW (Librazhd)
HEC “Lunik”, me fuqi 0,2 M MW (Librazhd)
HEC “Kerpice”, me fuqi 0,42 MW (Gramsh)
HEC “Ujanik”, me fuqi 0,63 MW (Skrapar)
HEC “Borsh”, me fuqi 0,25 MW (Sarandë)
HEC “Leshnice”, me fuqi 0,38 MW (Sarandë)
HEC “Velcan”, me fuqi 1,2 MW (Korçë)
HEC “Muhur”, me fuqi 0,25 MW (Dibër)
HEC “Rajan”, me fuqi 1,02 MW (Kolonjë)
HEC “Shoshan”, me fuqi 3 MW (Tropojë)
HEC “Lure”, me fuqi 0,75MW (Dibër)